

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

834-1  
S66

PERSERI MENGJEZ

Vehbi  
Skënderi

poezi

826-1

566

VEHBI SKËNDERI

X

# PËRSËRI MËNGJEZ

Poezi



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## **PERSERI NË LIQENIN E VAUT TË DEJES**

Në goftë se doni të dini si kthehet  
kaltërsia në grimca drite,  
dhe grimca e dritës në kaltërsi,  
vështroni këtë liqen!

Në goftë se doni të dini  
se si mund të lindin  
nga pika e djersës,  
dete, male e monumente,  
ashtu si lindin nga pika e bërthamës  
pisha e pyje,  
vështroni këtë liqen!

Në goftë se doni të dini  
se sa të kthjellët e të bukur  
janë sytë e Komunizmit,  
vështroni këtë liqen!

## P A R T I A

S'e fshehim. Ne hynim në këtë buzëshekulli  
të drojtur e të belbët si fëmijë.

Çapiteshim

e s'dinim se ku shkonim.

Me vite e shekuj prisnim ditën e madhe,  
me syrin në shënjestër  
e duke pritur vdisnim.

Partia qysh ditën që lindi thirri:  
— Mjaft pritmë!

S'e fshehim. Ne hymë në këtë buzëshekulli  
të qetë si shkëmbijtë dhe të shqetësuar si erërat.  
Dyshonim për çdo gjë e për çdo gjë besonim.  
Endnim ditë e natë, me fijet e ëndrrave,  
më me durim se Penelopa e legjendës

dhe pyesnim plot ankth:

— Kur do të ngrihet prapë nga shtrati Gjergj Elez  
Alia?

Partia qysh ditën që lindi dha sihariqin:

— Çdonjëri nga ne është një Gjergj Elez Ali,  
që mund t'i presë kokën çdo përbindshi.

S'e fshehim. Ne hymë në këtë buzëshekulli  
naivë si fëmijë dhe karasëzë si pleqtë.

Besimin tonë e kishim mbjellë  
siç mbjell veriu polenin  
në baltë e në hapësirë:

besonim tokën, detin, qiellin,  
besonim djajtë,ëngjëjt, shtojzavallet,  
që zhdukeshin (siç tregonin) sa ndjenin flladin e  
mëngjezeve,  
por nuk besonim në dashurinë e njerëzve të një ideali.

Partia qysh ditën që lindi lëshoi kushtrimin:

— Me këtë dashuri do të pushtojmë çdo majë mali! —

S'e fshehim. Ne hynim në këtë buzëshekulli  
me thesin e mjerimit përmbi shpinë  
dhe pushkën e Gjolekës përmbi supe.  
Por, ndërsa çanin tutje  
                        mes tufaneve,  
shushunyat e babzitura këllgjinin skutave  
                        vezët e nepërkave,  
ndërthurnin të papritura  
e deshën të shartonin prapë nëpër kërcejt e hallevë  
                        të popullit  
arrën e hidhur të robërisë së gjatë.

Partia qysh ditën që lindi thirri qartë:  
— Të djegim me barut çdo gram e çdo ferrë të keqe  
që mos t'ia zenë ferrat diellin kurrë  
kësaj toke me legjenda tremijëvjeçare.  
                        tremijëvjeçe.

1971

## **DIKUSH MENDON. . .**

Dikush kujton, se mendimet  
rrinë lakuriq si Eva.  
Mendimet veshin këmisha nate  
të purpura,  
në format e bukura të një femre si perri,  
edhe skërmiten nga ekrani  
me buzëqeshje verdhacuke:  
— Gjithshka është para!  
— Gjithshka është flori!

Dikush thërret e çirret:  
— Lernani nën hijen e ullinjve! Ç'na duhen armët! —  
E dini se luanin, mbretin e xhunglave  
mund ta shalojë çdo klloun cirku,  
e çdo borgjeze kapriçioze,  
po t'i shkulësh dhëmbët  
dhe po t'i presësh thonjtë e putrave?

Dikush mendon me vete:

«Jam i imunizuar dhe i papushtueshëm».

Por ju e dini mirë,

se një kala të fortë me mure qiklopiqë,  
që nuk e kishin shëmbur topat e flakëhedhëset,  
që nuk e kishin ngrënë dot epidemia dhe uria,  
që nuk e kishin tundur sa e sa tërmete,

e shembën

ca pikëza qorre,  
që futeshin në trupin e saj,  
(pa u vënë re)  
nga disa vrima e plasa

të fshehta.

Dikush mendon se mbaroi lufta

dhe mund të mbështetet i qetë  
në cohën e poltronave,  
për të ndjekur programet televizive.

Jo, jo!

Ata që na merrnin në shenjë  
me breshërima të plumbta,  
sot na qëllojnë me vesëra tingujsh.  
Dhe tingujt shkojnë më thellë

se plumbat dhe ciflat e  
predhave.  
Tingujt vrasin më shumë!

Gusht 1972

## THËNGJIJ TË KUQ

*Kovaçit të të gjithë hidrocentraleve  
Hazis Vorfi.*

Në kovaçhanë hyj e dal gjithnjë.  
Duart ustait posa qymyr i nxijnë  
herë tymos ndonjë cigare me të,  
herë trazoj thëngijjtë në kaminë.

Eshtë e vërtetë. Ti ke hak, Kulluci<sup>1</sup>):  
Ka gojë e flet... ka gjuhë prush' i kuq.

Vë mbi kamin' ustai dy-tri qysqi,  
e skuqen hekurat dalëngadalë si plitka.

---

1) Kështu e thërrasin minatorët, në mënyrë miqësore,  
kovaçin Hazis Vorfi.

Çekani rreh metalin me furi,  
lëvrijnë xixat... si mikrogalaktika.

Ustai nuk flet. Ç'mendon kështu, Kulluc?  
Qomyri nxin. Thëngjilli qesh... i kuq.

Si zogj cicërojnë tingujt metalikë,  
plot gjysmë-shekulli shoqërojnë ustanë.  
Dhe s'iu mërzit kovaçit kjo muzikë,  
ky hi... kjo blozë... dhe kjo kovaçhanë.

Më flet buzëgaz i rreshkuri Kulluc:  
«shkruaj një kajkë<sup>1</sup>) për hekurin e kuq».

Me minatorët ka sulmuar shkrepat,  
ja, ky usta! Ky armëtar pa shok.  
Dhe ka kalitur ushta majëmprehta,  
sa nuk kalitën as gjith'pirustët tok.

Bjeri çekanit, hej, Kulluc, Kulluc.  
Të njeh nga dora, ty, metali i kuq.

---

1) kajkë — kangë.

I rrjedh fytyrës djersa porsi urdhë,  
e shiu i nxeh të ballin ia lag.  
Por, prapë, ustai, rreh hekurin mbi kudhrë...  
I hekurt ngjan, edhe kovaçi plak!

Qëllo mbi farkë, hej, Kulluc, Kulluc!  
I duhet shekullit ky thëngjill i kuq...

*Zadejë 1968-1970*

## **VIJ NË SHTËPINË E PRINDERVE**

Vij në shtëpinë e prindërve,  
prind dhe vetë.  
Nuk po nxiton t'më përshëndoshë im' atë,  
duke më çjerrë faqeve me mjekër.  
Nëna s'po vjen të më rrokë në qafë  
me sytë tërë lot.  
Diçka mungon. Diçka nuk është më, ku ishte.  
Si mund të ndodhë ndryshe?

Vij në shtëpinë e prindërve,  
prind dhe vetë.  
Nuk po më qaset më ogiçi t'më lëpijë pëllëmbët,  
e nuk dëgjohet  
nga kulmet e dritareve  
dhe plasat nëpër trarë,  
cicërima e bulqëve;

nuk gjej më në kamare  
dy-tri gorrifica, e pak tel për opingat,  
e s'kundërmojnë erë ftojtë prej sënduqeve,  
që i kyçte gjyshja me tre çelësa.

Vij në shtëpinë e prindërve,  
i thinjur,  
prind dhe vetë.

Vij te njerëzit e afërt po nuk i gjej të gjithë.  
Gëzohem për diçka, pikëllohem për diçka...  
Shmallem e përmallohem...  
E jam posa një fushë manjetike,  
ku ndeshen papushim  
rryma të kundërta.

Fshatarët më afrohen përzemërsisht,  
fëmijët më shikojnë që nga qoshet  
dhe pemët më qëndrojnë si të shurdhëta,  
sikur s'cicerojnë zogjtë.

Vij në shtëpinë e prindërve,  
i thinjur,  
prind dhe vetë.  
Dikush më thotë (fëmijnia):  
— Nxito të kapim xixëllonja! —

— Eja të ngremë leqe për thëllëza e mëllinja!  
Dikush (vërsnikët përtetj deteve të viteve):  
— Eja të lahem i nga lumi posht'te jazi! —  
Dikush (mosha dhe zemra ime):  
— Fshatit i duhet gjimnazi...

Vij në shtëpinë e prindërve,  
i thinjur,  
prind dhe vetë.  
Dhe s'jam aspak i qetë...  
Mezi mbaj lotët prej gëzimit,  
kur mbështet mollëzat e gishtave  
butonëve të radios,  
e shikoj llambën elektrike në katua...  
E në të njëjtën kohë ndjej nostalqji  
për pishtarin, për kungujt, për qypin,  
e për gjymin.  
Ndofta se më kujtohet nëna me sqepar,  
tek çante pishë pranë goshkut  
dhe gjyshja me lahurinë e ri prej tymi  
shtrënguar nën gushë?

Vij në shtëpinë e prindërve,  
i thinjur,  
prind dhe vetë.  
Këtu në këtë truall janë ngjizur

(në një natë të errët pa pishë)  
stërgjyshët, gjyshët, prindët,  
unë vetë...

Porse gjithshka ka ecur,  
ka lëvizur...

Gora ime ka lëvizur,  
ka lëvizur

Lenia vetë!

## **SA HERË DO TË SHIKOJMË MALIN E DAJITIT**

Sa herë do të shikojmë malin e Dajtit  
do të na kujtohesh ti,  
o shoku Çan,  
e do të na shfaqesh prapë atje në majë,  
në një kuvend të lirë e të përjetshëm  
me erën dhe me njerëzit.

Sa herë do të shikojmë malin e Dajtit,  
do të na duket se dëgjojmë zërin tënd,  
mes zhurmash e radiosinjalesh:  
«Efiri është bërë panair  
ku lozin sot gjithfarë maskaradash  
e karnavalesh».

Sa herë do të shikojmë malin e Dajtit,  
do të na duket se dëgjojmë zërin tënd të çiltër:  
«O njerëz, ju kam dashur shumë,  
por pak më shumë,

Shqipërinë e kuqe»!

Sa herë do të shikojmë malin e Dajtit  
me gunën e reve të përflakura supeve,  
na bëhet se do dëgjojmë zërin tënd:  
«Unë kam hapur krahët n'efir,  
dhe kam ngritur një urë  
me mijëra kilometra gjatësi:  
që të kalojnë punëtorët drejt njëri-tjetrit,  
që të kalojnë kontinentet drejt njëri-tjetrit.  
Unë kam hapur krahët n'efir!»

Sa herë do të shikojmë malin e Dajtit,  
do të dëgjojmë zërin tënd,  
që sillet si shqiponjë në hapësirë:  
«Efiri është bërë fushë lufte,  
ku ndeshen papushim dy botë  
pa rreze kompromisi.  
E duken zero përpara kësaj ndeshjeje:  
Maratona, Vezuvi, Austerlici!»

Sa herë do të shikojmë malin e Dajtit  
ngarkuar me mjegull,  
do të na kujtohesh ti, o shoku Çan,  
dhe ajo ditë vjeshte plot me shi,  
kur i përloti gjithë Tirana sytë,  
ndërsa po të mbuloni ty në varr;

në këtë tokë,  
tek kemi mbuluar Nondën, Nasin, Lymin, tim  
vëlla  
në këtë tokë,  
ku kemi mbuluar gjithë të dashurit,  
dhe kemi mbjellë ëndrrat më të bukura.

Sa herë do të kujtojmë malin e Dajtit,  
që është i përjetshëm,  
do të na kujtohesh ti,  
o shoku, Çan Pa Y.

## **KUR SHKONIM NË LUFTË**

Kur shkonim në luftë,  
çatitë e reve breronin pika shiu,  
kupolat gri të ditëve-plumbë,  
zemrat-pika gjaku.

Kur shkonim në luftë,  
aty ku breronin pika shiu  
mbinin fije bari, lule e bimë,  
aty ku breshëronin plumbë,  
pikonin petële lulëkuqesh  
dhe vezullonin yje.

Kur shkonim në luftë...

## K A F J A L E

Ka fjalë që shkëlqejnë posi gurëzit pas shiut,  
 ka fjalë që të veshin në mëndafsh e në gëzof,  
 ka fjalë që rrëshqasin  
    si gjarpërinj,  
 ka fjalë që kërcasin si urof.

Ka fjalë që kërcejnë posi pleshta,  
 ka fjalë që dredhojnë posi plumba,  
 ka fjalë që rëndoijnë  
    si shkëmbinjtë nëpër kreshta,  
 ka fjalë transparente dhe të lehta posi shkuma.

Ka fjalë si gishtrinjtë e butë të një femre,  
 ka fjalë si curril i kthjellët,  
    që rrjedh vapës nëpër misra,  
 ka fjalë që të mëndin,

posi bletën lulet e një peme,  
ka fjalë që cicërojnë si bilbilat nëpër lisa.

Ka fjalë më të dhimbshme e më të mjera se mjerimi  
ka fjalë më të qeshura e më të ngjyrshme se  
pranvera,  
ka fjalë më miope dhe të mjegullta se hutimi...  
Gabon kush thotë:  
fjalët i merr era.

Ka fjalë aq të kapshme dhe solide si betoni,  
ka fjalë që të djegin e të grijnë si acidi,  
ka fjalë si një popël buzë honit,  
ka fjalë të fuqishme e stoike si Akili  
ka fjalë të guximshme që s'i mbyt dot as litari  
ka fjalë, që shtegëtojnë posi drita  
ka fjalë, që s'i bën të heshtin as varri...  
Ka fjalë —  
shkallë ku rrëmeti ngjitet.

## **P E R P A R A**

Diçka kam bërë pér t'ecur tok me kohën.  
Jam pjekur nëpér vapë si një gjëmb i egër,  
degë më degë jam përpjekur.  
Kur numëronin vërsnikët  
gurëzit e lumit dhe yjet,  
kam numëruar, në sahan, kokrrat e fasuleve  
dhe ditët e mjerimit.

Pastaj kam numëruar fyshekët.  
Kështu kam mësuar të numëroj.  
Porse dikush më ka tërhequr veshin:  
— Kjo është pák.

Jam bërë hamall.  
Kam mbartur në kurriz  
barrën e dhimbjes e të urrejtjes

(urinë, varret e shokëve, fshatrat e djegura)  
nga një mal në një mal,  
    nga një gjeneratë në një gjeneratë,  
    nga një epokë në një epokë,  
dhe s'kam harruar se armiku i klasës  
                pret hakmarrjen.

Porse një zë, nga thellësia, më ka grishur:

— Ka shumë për të ecur.

Për mua, fshatarin, ka qenë më lehtë  
të sulmoja trekëndëshin e fortinës,  
që e ruanin tre mitralozë,  
se sa të futesha në «tercinën» e Petrarkës,

    tek priste Laura e çiltër,

Por koha më ka thënë qartë:

— Duhet pushtuar çdo kuotë.

Për mua, fshatarin, ka qenë më lehtë  
t'i ngjitesha një shkëmbi të thepisur,  
nën gjëmimin e sharapnelëve,  
se sa të hipja dy-tri shkallë  
në tempullin e bardhë të Atenës.

Por më ka cytur përsëri një zë i afërt:

— Përpara!

Dhe unë, që dikur kositja qafat e gjembaçëve me  
shkop,

kur zemërohesha me ta, se më gjëmbonin këmbët,  
iu kam sharruar kokën minareve, kumbanoreve  
dhe «të madhit zot»,  
iu kam shkurtuar qafën idhujve  
në çfarëdo kapele-izmë  
që janë shfaqur,  
por prapë një zë i afërt më ka thirrur:  
— Përpara!

## **JAM MOSHATAR . .**

**Jam moshatar me këtë rrap degëprerë,  
                                si një invalid lufte,  
që shpesh më ka përcjellë  
                                me nënën tok në luftë.**

    Fëmijnia ime shkoi kësaj rrugice fshati,  
gishtérinjtë gurëve duke vrarë.  
    **Jam moshatar me këtë rrap degëtharë,**

**Jam moshatar me këtë rrap degëprerë.  
                                si invalid lufte,  
që mban në duart cung  
                                dy izolatorë të bardhë,  
si dy nipa të bukur.**

## **D R I T A R E T**

Dritaret janë sytë e dhomës,  
ku jetojmë unë e ti.  
Dritaret janë sytë e kohës,  
herë të qeshur, herë të menduar,  
e ndonjëherë pak skeptikë.

Dritaret — sy,  
ojnat e perdeve — qerpikë.

Dikur, dritaret,  
si sy prej iriqi  
vështronin të shqetësuara  
nga ballet e vrenjtura  
të kullave si kreshta.  
Vërtiteshin natën ujqërit,  
hakmarrja,  
mesjeta.

Dritaret janë sytë e dhomës,  
ku jetojmë unë e ti.  
Dritaret janë sytë e kohës.

Dritaret janë  
kornizat e thjeshta të peisazheve,  
që na servir natyra zemërgjerë.  
Hyn përmes tyre dimri,  
prilli, gushti, vjeshta,  
(me flutura bore, me lule, me gjethe të kuqë-  
rrremta e me pemë),  
hyn bota e tërë.

Hyjnë, përmes tyre.  
zhukatjet e bletëve  
nga një dardhë e çelur,  
shushuritja e pjergullave,  
kur lidhin nyjet,  
me atë erë të athët, pak të lagët;  
aroma e tokës së mbjellë  
flladi i mbrëmjes,  
xixëllonjat e gëzuara dhe yjet,  
ndofta të lodhur,  
nga shtegëtimi i largët.

Hyjnë, përmes tyre,  
një mollë plot lule të kuqe,  
ku cicërojnë zogjtë,  
zhurma kombajnash, e zëra njerëzish  
në lëmë,  
muzikë

nga emisioni «Këngë nëpër botë»,  
edhe një natë fshati me hënë...  
Dritaret janë sytë e dhomës  
ku jetojmë unë e ti.  
Dritaret janë sytë e kohës.

Këto të gjitha nuk i dija,  
ka gjithnjë të papriturajeta,  
m'i kanë thënë, në fshat kur isha,  
nuset e vajzat fshatare,  
kur po shkatërronin dritaret e vjetra.

## **Z J A R R M E T A R I**

Ne njihemi qëkur, o zjarrmëtar.  
Na kanë ngrénë çizmet këmbët, kemi mbajtur xhup,  
na ka përzhitur vapa, jemi tharë në acar  
dhe kemi pirë, shpesh, kafe në klub.

Por, sot, që mora penën për të shkruar.  
e ndjekam veten ngushtë.

Ne jemi shokë. Nuk mund të them për ty  
me ton kalorësiak: «Sulmon posa luan në çdo  
përleshje»!

Oh! Po të cirresha kështu,  
gjithë ditën, ti me mua do të qeshje.

As nuk thur dot pér ty lëvdata tē stérkipura:  
«I pathyeshém»!  
«Heroik»! «I zjarrtë»! «Gojëmjaltë»!  
Pér shokun duhet folur krejt natyrshém,  
siç mund tē fliten fjalët:  
ujë... bukë... baltë...

Ndaj qindra herë i kam shkruar këto vargje,  
e qindra herë i kam fshirë;

dhe nga gërmadha fjalësh kanë mbetur këto rreshta:  
ti je punëtor, e je njeri i mirë,  
që mbi tē gjitha tē kënaq e drejta  
e klasës sate.

Ti flet, si tē tē vijë, tē thata e tē njoma  
(pa e värtitur, posa shkesët rrëth e qark)  
dhe tē mërzitin frazat si vërzoma,  
që kanë shumë byk, e drithë pak.

Nuk je dakord? Ç'më bën jemin me kokë?  
Mos po marr miell nga thesi i tjetrit, hua,  
dhe po e shes si miellin tënd?

Më thuaj,  
mos po të sjell ndonjë kaçile vesë,  
të mbledhur pikë-pikë lule më lule?  
Jo! Këta vargje bien erë djersë...

Dhe ka në ta,  
diçka prej ngjyrave flakëruese të netëve të sulmit,  
e të ditëve të zakonshme, që kalon kantieri.

E ndofta je dhe ti në ta.  
Po, ti  
në ankthin tënd,  
kur rri dhjetë orë rresht në mbushje,  
e të pëlcasin hundët për cigar.

Me shqetësimin tënd,  
kur hidhet gjer në qiell ai fontan me ngjyra larushe,  
ndërsa ti pyet veten:  
«A kanë marrë gjith' kapsulat zjarr»?

Po, je dhe ti,  
që ndonëse tri dekada rend kantiereve,  
duke të rrahur breshëri, erërat e lloha,  
e duke larë vetë boçkën me lëvere,

të ha si mola në zemër, ky merak:  
«E marrtë e mira po më ikën koha...  
Edhe për socializmin,  
kam bërë shumë pak».

## **NATE NË KANTIER**

Errësirë. Dritë. Bardhë e zi.

Shkëlqejnë reflektorët.

Diku nga një lartësi një shi xixëllonjash bie,  
si të thërmoheshin kushdi se sa kometa;  
ndërsa më tej në qoshe  
një prift i veshur me pelice

gërmuqet nën hije

e murmurit me vete:

— Skëterë gjithëve ju djegtë! —

Ndërkaq, përsipër kullave, korpuseve e gjithë këtij  
ambienti

real e fantastik.

që ndodhet pa pushim në lëvizje e në luftë,  
lartohet si një bredh i madh

vinci-derik,

që shtrin një krah drejt yjeve,  
sikur kërkon t'i heqë zotit ndonjë shputë.

## **DITËN QE U BERE TI DY VJEÇE**

Nxitova që tē zë nëpër lëndinë  
një flutur krahëshkruar.  
Por ti e di, se xhaxhi s'është aq i ri,  
ndaj nuk ja dola dot me tē vrapuar.

Ngulmova që tē kap një zog tē vogël,  
me brez tē kuq nën gushë.  
Porse sa herë shtrija drejt tij dorën,  
më fluturonte në tjetër gëmushë.

Mendova që tē mbledh një grusht xixëllonja  
e ballin ty me to tē ta stolisja,  
por xixëllonjat janë delikate  
dhe pata frikë mos i vrisja.

Zbulova në korie disa lule  
buzë burimit, mes gurëve të strukura.  
Por nuk pata guxim që t'i këpusja,  
se ishin të vockla dhe të bukura.

Dhe si u lodha qark duke kërkuar  
erdha tek ti, vogëlushe, quarbosh,  
por ti besoj s'do të më zemërohesh  
dhe ndofta nuk do të më qortosh.

## **DUKE KUVENDUAR ME NIKO BELLOJANISIN**

*A ju kujtohet busti i Niko Bellojanisit  
në kampin e pushimit të punëtorëve në  
Durrës?*

Përse po më vështron? E ç'po më thua?  
Ti rron si të gjithë ne, midis të gjallëve...  
Dhe nuk të ngjan i huaj timbri i fjalëve  
në këtë vend të huaj,  
sepse kudo takon në sytë e shokëve.

O, Niko Bellojanis,  
ti kuvendon me ne, e hedh vështrimin larg...

Ke ëndërruar shumë,  
të çlodhen punëtorët bregdeteve të kaltra  
në vilat e borgjezëve;  
ke ëndëruar shumë të ecin punëtorët kryelartë,  
kur marrin turnet, mbrëmjeve e mëngjezeve;  
ke ëndërruar shumë, që të hapen për punëtorët  
dyert e shkollave, spitaleve dhe qiejve...

O, Niko Bellojanis,  
shih punëtorët në verandë,  
të lirë, të shëndetshëm, të gëzuar;  
duken sikur të thonë:  
«Këtu nuk të qëllon njeri pas krahëve,  
këtu nuk të gjurmon spiuni i asfalise,  
këtu nuk të bastis mesnatës banda e korofillakëve,  
këtu nuk të përgjojnë, kërkund, sy të dyshimtë...»

O, Niko Bellojanis,  
punëtorët po të presin, sot, për drekë,  
siç presim ne shqiptarët miqtë e rrallë.  
Dhe ja, kryen e vendit për ty e ruajnë, në sallë,  
e mund të ulesh midis nesh, siç shtroheshe mes  
dokerëve të Piresë.  
E mund të ulesh midis nesh,  
siç shtroheshe mes muratorëve të Athinës,  
mes partizanëve të Gramozit të shkrumbuar,  
dhe mund t'ua marrim, tok, gjithë këngëve që dimë,  
pa pasur frikë se mos na mbeten këngët pa kënduar.

Po ti vëlla pse hesht?  
Mos këto fjalë të gëzuara,  
shesheve e korridoreve të pastra,  
kjo rërë dhe këto të shkujdesura gjurmë

e këto vajza, që kërçejnë si pulëbardha në ujin  
e kaltër,

ky ajër, që bie erë jod,  
e këto dallgë me nga një takije shkumë  
dhe kjo varkë e vetme, që rreh detin nie lopatë  
po të kujtojnë varret e panumërtë shokëve,  
shpërndarë mes shkëmbinjve të Egjeut,  
në ishujt e thatë?

Ti prapë hesht?

E pse po vrenjtesh në fytyrë,  
duke vështruar detin, që diçka të flet?  
Mos kjo buçimë e përjetshme kaq e gjatë,  
që del si pshërëtimë e thellë,  
po të kujton atë mëngjez të kthjellët,  
kur teksa dielli derdhëte mbi Olimp thëngjij e  
shpuzë,

ti prisje në kraharor bataret' e xhelatëve  
(buzëgaz, sikur mos të të qëllonin ty,)  
me atë trëndafil të kuq në buzë,

O, Niko Bellojanis,  
shushurijnë degët e plepave e të pishave,  
sikur shoqërojnë zogjtë,  
që cicërojnë,  
sikur freskojnë ballin tënd të bronxtë,  
sikur diçka për ty u thonë trëndafilave...

**Ne shkelim pa vëmendje nëpër rërën, që na djeg  
si shpuzë,  
e të shikojmë, ty vëlla, plot dashuri,  
me atë trëndafil në buzë...**

**1963-1973**

## **VESHTROJ KËTË LIQEN DHE NUK DL . .**

Liqeni i Vaut të Dejës —

posi dy sy të kaltër në mes të maleve,  
më i tejdukshëm se një qelq.

Shikoj në thellësi:

gërmadha, nulla e murrana,  
frëngji si sy të shuar, peshq...

Edhe nuk di:

peshq ka më shumë në të, apo legjenda.

Liqeni i Vaut të Dejës —

rrethuar me shkëmbinj, me kodra e me brigje,  
me bërryle të dala si mëngë,  
e gjire si pyka të futura.

Në kthjelltësinë e tij lahet hëna,  
si grua e bukur lakuriqe,  
e dredh mustaqet Leka nga bedenat,  
e teshëtin e shkuara.

E vërej dhe nuk di,

se ç'ka më shumë thellësive,  
yje, apo legjenda?

Liqen i Vaut tē Dejës  
roitin plasave tē shpellave  
  lule tē ndryshme:  
frashëre, trumba drizash e sherbela.  
Dhe po tē mbyllësh sytë një çast,  
tē vjen se hapin velat e shumngjyrshme  
  mijëra lundra,  
që turren rrugëve tē kaltra plot dredhëza.

Nga shkojnë vallë këto lundra?  
Nga Komani, nga Fierëza?  
Shikoj në thellësitë e tij dhe nuk di,  
gurëz ka më shumë ky liqen, apo ëndrra?

Liqen i Vaut tē Dejës —  
diçka e mrekullueshme  
mes tē vërtetës dhe ëndrrës,  
mes ndodhisë dhe legjendës.  
Vështroj këtë liqen edhe nuk di ç'ka më shumë:  
ëndërra dhe legjenda, apo ujë?

## **KA MBI NJË ÇEREK SHEKULLI**

Ka mbi një çerek shekulli,  
që është prishur në kraharorin tim qetësia.  
Ka mbi një çerek shekulli,  
që bëj gjumë të copëtuar.  
Ka mbi një çerek shekulli,  
që rrëmih në minierat e zemrës së madhe  
të popullit,  
për të gjetur atë mineral të pavdekshëm,  
si vetë populli,  
dhe për të derdhur në furrënaltat poetike  
poezi për komunizmin.

Dhe prap' rrëmih e rrëmih!  
Dhe përsëri e përsëri më shqetëson pyetja:  
A do të zbres dot,  
thellë,  
në minierat e zemrës së madhe  
të popullit,  
që të gjej atë mineral të pavdekshëm  
si vetë populli?

## M E S N A T E

Ja, drita ngjyrë vjollcë e saldatriçes,  
si shpend përrallor tund krahët mbi shkëmbinj.  
Po bie shi.  
Mbi mëngët e peliqes,  
një grusht margaritarësh farfurin.

E dashur, prapë, me ty dhe kësaj nate jam.  
Ndërsa po fryn veriu si në dhjetor,  
unë mbledh pikat perla...  
thur për ty gjerdhan,

t'u mburresh shoqeve ndër të diela:  
— Shihni, c'më ka sjell' ai,  
im shoq punëtor!

## **Ξ Α Q K A**

Nuk them se ka tē tillë njerëz shumë,  
por shkruaj, që tē mbeten sa më pak.  
E njihni shokun Raqkë?  
Një gjysmësyri tribunë,  
një gjysmësyri masë.

— Atëhere nuk ke ç'thua, e shpon dikush nga  
salla.

— E kush guxon.  
të mbjellë në ndërgjegjen time hala?! —  
Kërcen i nervozuar shoku Raqkë,  
e pasi turfullon disa sekonda,  
sikur tē mbante në kurriz tre barrë derte,  
fillon e murmurit me vete:

«Pse tē guxoj?

I kam tē gjitha: post, fëmijë, grua...

Televizor,

shtëpi komode me parket!

Eprorët më çmojnë,  
                            deprorët kanë respekt.  
Jam pa një kleçkë...»

Dhe që të ndjehet plotësisht i qetë,  
                            filozofon përafërsisht:  
«Pse të vozit në lumë,  
                            kur shoh se uji nis turbullohet?  
Pse të kërcej i pari mes ndeshjes,  
                            kur pret pas qoshes e panjohura?  
Pse të kaloj në shtigje të pashkelura,  
                            kur kam përpara bulevardet?  
Pse të rrëshqas në thellësitë e ujërave,  
                            kur s'di q'më pret në fund të detit?»

E i kujtohet gruaja,  
                            e mençura Marie:  
«Raqkë, kujdes, më qafsh,  
genushi im, nuk ka si qetësia.»

Dhe prap' mendon:  
«Ka hak Maria». .

\* \* \*

Ca pika shiu  
cicëruan nëpër xame.  
E ca cicërimë zogjsh  
breruan  
nga degët e një kumbulle të çelur,  
sikur të deshnin t'imitonin shiun.

Dhe papritur  
unë s'po kuptoja dot:  
cicëronte qielli,  
apo cicëronin zogjtë.

## **KUR SHKOVA PËRSËRI NË FSHAT**

Kur shkova përsëri në fshat,  
kujtova se do të më qortonin kumbullat,  
se kishin kohë që s'më kishin parë,  
por ato shtrinë krahët  
të më përqafonin.

Kur shkova përsëri në fshat,  
(pas shumë viteve)  
kujtova se do të më hiqnin veshin pleqtë,  
kurse ata,  
(ata të paktë që nuk kishin vdekur)  
filluan që të derdhnin lot nga malli  
dhe nuk po flisnin asnje fjalë dot.

Kur shkova përsëri në fshat,  
kujtova se nuk do të më njihnin rrugët,

se rrugët janë si lumenjtë  
që gjithnjë lëvizin,  
por kishin mbetur prap'diku halicë,  
(ndoshta për të më pritur mua)  
dhe zemra më rëndoi nga malli,  
sikur t'i mbante ata gurë  
të gjithë,

“  
“  
“  
“  
“  
“  
“  
“  
\* \* \*

Çudi!

Rruga për në hënë u shkurtua shumë.  
Për ditë afrohemë me planetë.  
Por rruga e dashurisë

Çudi!    prapë se prap' e gjatë...

Si ndodh në ietë.

## PUSHTIMI I LARTESISE

Dy jemë:  
një mësues, një ishpartizan.  
I ngjitemi kalasë  
në sulm imagjinar.

Brinj' e saj e ngrënë  
dhe e rjepur,  
djegur nga vapa e nga lufta.  
I qepemi link  
vragave e shkall've të shtufta.

Shpojnë rrezet plumb,  
nxjerr toka flakë.  
E si e ngjiti Muharrem Collaku<sup>1)</sup>  
këtë majë,

---

1) Muharrem Collaku dëshmor.

me atë trup plot plagë?

Toka është e ngrënë  
dhe e djegur.  
Topat, posa ujq e kanë ngrënë,  
e kanë zhvatur,  
e kanë rjepur.

Dy jemi:

një mësues, një ish-partizan.  
Na thahet buzëve pështyma.  
Ecim.

Rrëzohemi  
duke u ngjitur

e përsëri ngrihemë.

Ky ligj i rreptë  
u duhet çmuar tepër gjyshërvë dhe  
bashkëkohësve.

Ngjitemi...

Dikur, në këtë majë, enkelejtë  
u ngritën maqedonasve  
mure ushtash.

Dhe prapë ngjitemi...  
Kjo lartësi  
na duket barometri,  
ku kanë matur pulsin shekujt...  
duke nxituar nga njeri tek tjetri.

## **NËN NJË VËSHTRIM TË AKULLT**

E dini ç'bëjnë gjyshet?  
Thëngjijtë i mbulojnë nëpër hi,  
të ndezin porin përsëri,  
të bulullojë gjithë dimrit zjarri.

Kështu dhe ti e dashur:  
mbulon nën një vështrim të akullt  
një dashuri të zjarrtë,  
që nuk e shuajn' dot as vitet.

## N E N A

Nëna ime  
është (si gjithë nënët) nënë,  
kur vonohem,  
bëhet një me prevazë e dritares  
dhe ku nuk i vete mendja.

Ngjyrat që ka lumtëria,  
e ngjyrat që ka dhëmbja  
i vërej përditë te nëna.

Nuk është e vërtetë,  
që njeriu një herë lind,  
e një herë vdes.

Nëna është një copë tokë,  
një copë oqean,  
një copë galaktikë:  
ku vdesim e lindim për ditë,  
që të bëhem më të mirë e më të drejtë.

Nëna.

Nuk është e vërtetë  
se ajo është vetëm një plakë,  
ku skleroza në çdo qelizë ka ngritur leqe.

Nëna ime  
është shoqja më e afërt e s'ime mbese,  
që kthehet nga kopshti  
(shih tek lozin tok si moshatare!)  
Është vajzë e rritur,  
kur nisen mbesat në aksion.

Nënë, në përkujdesje  
dhe gjyshe...

tetëdhjetvjeçare.

Nëna

e afërt,  
e gjërë,  
e ngrohtë.

Bën shoqëri me ne

dhe gjyshërit e stërgjyshërit tanë.  
Nëna është një sheltore,

ku pleksin rrënjjët e degët dy botë,  
ku qelizat e dy botëve

ndeshen e përplasen vazhdimisht  
dhe vazhdimisht

rrinë pranë e pranë.

## **KA BOTA PLOT QYTETE . .**

Ka bota plot qytete antikë  
dhe modernë  
me tru elektronikë,  
që peshë mund ta ngrenë tokën,  
(si galaktika vezullojnë natën)  
por çdo të kremte,  
puthen me lot në sy  
me shënjtorë e me ikona,  
duke kënduar në kishë litani  
— Allilla, allilla, o zot mëshirona!

Ka bota plot qytete të kristaltë,  
që natën gogësijnë si elefantë,  
e hingëllijnë me piskama;  
flakërojnë nëpër dete dritash të shumëngjyrshme,  
e reklama;  
rrëqethen plot drithrima nga ethet e fitimit,  
e duke u cirrur i mbyt kolla:

— Hej blini koka-kola!

Ka bota mjaft qytete të çuditshme,  
ku mund të grisë barkun qielli  
nëpër grataçielala,  
si përmbi majën Everest  
dhe dinosauri i shekullit XX,

paraja,  
shtyp nën putra posa milingona  
krijuesit e grataçielave e gjithë mrekullive  
dhe u'lërin plot ankth, duke iu marrë fryma:  
— Alilluja, alilluja, o zot mëshirona!

Ka bota plot qytete të mëdha e fantastike,  
me bulevarde më të gjëra se sa Nili

dhe lumi Jance,  
që notojnë në dritë.  
Me parqe,

ku blerojnë mijëra pisha, panja, ekualiptuse,  
e kundërmojnë gjithë lulet e trëndafilët e planetit,  
po, kur vjen nata,

qytetarët,  
që krënohen me emrin e qyteteve të tyre,  
e ndjejnë veten  
pas portave, pas mureve e grilave,  
si midis xhunglave,

mes tigrave dhe boave,  
e duke u strukur nga frika dhe asfiksia,  
murmurisin me zë të dredhur:  
— Alilluja, alilluja, na mbrojttë perëndia!

## **R E V O L U C I O N I**

Rastis edhe kështu (mos u çudit!) në jetë:  
nxjerr flak' e tym vullkani qindra vjet,  
dhe më së fundi hesht. Pastaj fillon zë korë;  
qeleshe e hirtë duket si dëborë.

Por, po të çash koriçkën, që zbardh posa tenda  
ti vren se llava lëshon zjarr, valon, e zjen  
përbrenda.  
Pra, nënë këtë kore «të ftohtë» që shikoni  
vazhdon, në pambarim, revolucioni.

## M U S O N E T

Jam shtrirë në krevat.

Dua të fle;

veriu çik krahët lehtazi pas perdeve.

Dikush më flet...

Gjumin m'a vret

ky zë.

Dikush nuk mund të flejë nga gjëzimi.

Dikush nuk mbyll dot sy,

Mua m'a mbyt qetësinë dëshpërimi,  
se pret diçka me frikë.

mes telave plot gjëmba,

në fshatrat strategjikë.

Mua më vranë prehjen sot,

në Domenikë.<sup>1)</sup>

---

1) Është fjala për krimet e agjentëve amerikanë në Republikën Domenikane.

Mua m'a farmakosën gjumin  
lëndët helmuese,  
fytyrat e fëmijëve  
e kajëzave të vyshkur  
dhe thirrjet «humaniste»,  
që nxjerrin vrasësit  
nga gurmazi i ndryshkur.

Dhe s'kam qetësi,  
megjithëse është natë.  
E nuk më hyn në sy as libri,  
as vetëvetja.

Nuk qëndroj dot as më këmbë, as mbështetur.  
Hap radion. Ja një bashkëfolës!  
Dikush pa gjumë paska mbetur...

Një bombë paskan hedhur prap jankitë  
mbi kalamajtë e shkollës  
në Nan Din!

Errsira nxin...  
Nuk di përse qep sytë mbi antenë.  
Sikur dëgjoj buçimën e deteve,  
që s'flenë.  
Me radion bisedoj.  
Shëtit mbi paralel' e meridianë.  
Në dhomën time shushurijnë

gjith' pyjet aziatik' e afrikanë.  
Shihni, një grup zezakësh,  
të shkathët si kangurët,  
jankin' e detyrojnë të përtypë:  
— kanellë, bajame, mastikë?  
Jo!  
Flamurët,  
e «së pamposhturës» Amerikë.

Në Vietnam, në Bolivi — përpjekje.  
Drejtësia po dënon,  
një Xhon me vdekje.  
Prologu i sa gjyqeve të nesërme!  
Prologu i triumfit të të drejtëve!  
Kjo parandjenjë, oh, ç'më përtërit.  
Ky lajm,  
që fluturon n'efir gjithkund,  
ja, shpirtin sonte m'a flladit  
sa tërë krojet, gjethët, flladet  
e pyjeve pa fund.

E plot gëzim kérkoj nëpër efir  
stacionet,  
me to gjer në mëngjez të bisedoj.  
Kérkoj. Njëzet... njëzet e pesë megaherc  
— Musonet!

**Ky lajm errësirat merr.**

**Këto nuk jan' aspak të dhëna sinoptike,  
me «shira dhe stuhira të përkohshme».**

**— Musonet!**

**Urrejtja popullore prej kohërave antike  
gjer në ditët e sotshme,  
urrejtja popullore!**

**I zgjon nga gjumi pas mesnate Xhonët...  
Musonet!**

P O E T

Ka shumë vjet që po rrëmih në veten time.  
(Ndofta nuk kam rrëmuar kaq as në selishte),  
kam çarë në fillim me kazmë  
e par mendë.  
Por plori, duket, vetëm më gërvishte,  
dhe mezi mbinte gruri.

Pastaj kam nisur të lëroj me damaluk.  
Térhiqnin qetë nga mëngjezi gjer në mbrëmje,  
e nxirrin që nga toka grem e gjëmba,  
(jo pa gjakosje e dhëmbje)  
dhe mbinte gruri pra' me egjér e me urth.

Ahere nisja të lëroja dyfish edhe trefish:  
me plug e me traktor, qilizmë.

Dhe bashkë me kërçelet e lisit e të shkozës  
nxırrja nga vetja ime  
kércej komunesh, kafka shenjtorësh  
dhe kufoma perëndish.

Shkriftohej toka si bukëvale,  
e mbillja përsëri me lesë.  
Ta marrë dreqi! Si-edhe më parë,  
më mbinte gruri prap' tek-tuk me egjër.

I inatosur nisja nga fillimi:  
me plug, me buldozer dhe martinel.  
Tok me kërçelet e me gramin dilnin,  
hundë kapadainjsh dhe nofulla indiferentësh.

Kështu duke rrëmihur  
me plugje e me martinelë,  
ndjeva zëra të njohur që më këshillonin:  
(ndofta zërat e shokëve të vrarë!)  
— Poet, rrëmih, qilizmë sa më thellë  
në veten tënde,  
të mbjellësh grurë... për Revolucionin!

## **E R N E S T I**

Ernesti thur përpara vetes  
gardhe buzëqeshjesh marramendëse,  
si një mëngjes boreal që të rrëmbe  
me të parë.

Ernesti mund të ngrejë pallate me fjalë.  
(sidomos kur ndodhet para superiorëve),  
më të çuditshme, e më të bukura se në çdo përrallë.

Ernesti nuk vesh dok, terital e rroba të pambukta,  
por një kostum me luspa.  
Dhe, që të duket me çdo kusht modern,  
të flet për çdo artist e çdo roman  
kontemporan.

Veç kur gjen një dritare e hyn brenda tij,  
të duket vetja si në një han,

që ka tri vjet pa fshirë,  
ku çdo gjë bie erë myk  
e vjetërsirë.

Ernesti ka kulturë dhe mund të ngrejë kala  
edhe me rërë,  
e të t'prishë mendjen me citate  
shifra, emra, data  
nga Morua deri te Tuqididi,  
e prapë nuk ka të mbaruar...  
Por, po të gjesh një plasë, e të hysh brenda tij,  
do shohësh se çdo gjë  
ka shtresa acidi.

Çdo gjë... është e acidizuar.

Ernesti...  
I kulturuar, i mençur, i sjellshëm, i njerëzishëm.  
Vërejeni mirë,  
me qindra djaj ka nën kafkë.

Ernesti  
mund të kthehet në çdo çast  
në përbindsh.

Vërejeni mirë!  
Poshtë njeriu maskë!

## LAMTUMIRE, MËSUESE

Ne hipim në një tren  
dhe në të njëjtën kanape po rrimë.  
Ty, duket, fusha e verdhë të pëlqen.  
Mua, kallinjtë e leshrave të tua.

Vërtiten rrrotat

përmbi shinë,  
sikur diku po rrokullisen.  
Dhe bëj të them diçka,  
                               e them gjëra të kota,  
dhe bëj të dal diku  
                               e s'mund të nisem;  
m'a davaritin mendjen fare  
                               këto flokët e gjata,  
që shpupuris veriu  
                               nëpër dritare.

Të qeshin plot gëzim ata të kaltër sy,  
tek përshëndet me dorë  
ndonjë fëmijë dhe pemët fluturuese ,  
që duken se vrapojnë për të të arritur ty:  
— Lamtumirë, mësuese!

## J A P O E Z I A

Isha diku, por nuk mbaj mend ku ndodhesha  
(në zall, në fushë apo në mal),  
i etur tmerrësishët për poezi,  
si toka e djegur për një pikë shi,  
Kur dikush thirri:  
— Ja poezia!

I hodha sytë andej,  
e pashë një burim të kthjellët,  
që vezullonte nën një kodër rëre.  
Nxitova menjëherë të lag buzën.  
Oh, kur arrita humbi i tëri!

Por, pas disa minutash,  
Jo! Pas disa orësh,  
                                (ashtu m'u dukën ato minuta!)  
thirri dikush sërish:  
— Ja poezia!

I dhashë vetes:

m'u bënë duart si dy lugë eskavatorësh,  
e nisa të rrëmih zhavor e rërë  
në rërën e dystuar prej mijëra vjetësh.

Ai burim

fanitej, buzëqeshte

e zhdukej përsëri.

Unë rrëmihja dhe më me furi.

Ndofta, zezakët s'kishin rrëmihur kaq  
në brigjet e Nigerit,

për dy-tre gram ar!

Ndofta, bengalasit në shkrepat e koraleve,  
nuk ishin lodhur kaq për një perlë,  
duke rrëmihur oqeaneve!

Dhe poezia fanitej

e zhdukej përsëri.

Unë rrëmihja dhe më me furi

në rërë,

e kur kisha zhvendosur (pa e vënë re)

një mal të tërë,

filloi të vezullojë poezia.

U turra,  
si i eturi  
syrit të një burimi  
e laga 'buzët, e filladita shpirtin  
dhe duke qeshur i tëri nga gëzimi...  
u zgjova.

Fërkova sytë:

«kjo ndofta është e vetmja ëndërr e vërtetë,  
që kam parë  
gjith jetën».

## **ELEGJI PËR KRYESONDISTIN**

Të patëm parë, shpesh, shtrëngatave dhe rreshjeve  
si një vetëtimë n'errësirë.

Aty ku tundej dheu prej ndeshieve,  
kërkoje tjetër front... më të vështirë.

Tashti qëndron, në baltë, pa lëvizur.  
Një krah ke hedhur hark, si pa vëmendje.  
Në kanatiere gjaku t'është mpiksur;  
të shohim... e na rrjedhin lot prej dhëmbjes.

Të flasim... po ti s'mund të ngrihesh sot.  
Je nderë para nesh, këtu, në tokë  
dhe mbasi nuk mund të të vrejmë, kështu, dot  
po të mbulojmë me pelice kokën.

Ti nuk jeton më shok!

Nuk do ta thekim, tok, më bukën në furnellë  
duke ndjerë erën e këndshme të brumit.

Nuk do ta presim, tok, mëngjezin kur të çelë,  
dhe s'do dëgjojmë këngët e valëve të lumit.

Nuk do strehohemi në shi, nën një barakë,  
e s'do t'i ngrohim mbi një zjarr pëllëmbët;  
nuk do ta presim, më, tufanin bëashkë  
dhe nuk do rrimë, n'avari, tri ditë më këmbë.

Ti nuk do kïhehesh kurrë! Është e qartë:

Ne shokët të përcollëm vetë...

Asgjë s'na le, kur ike në barrelë shtrirë,  
veç disa bulëza gjak aty në baltë,

dhe këto fjalë — testament:

— Do të luftoj te fronti m'i vështirë! —

Dhe i dëgjuan valët këto fjalë

dhe ndonëse s'kanë folur kurrë,

këto tri fjalë i mësuan mirë,

t'i shpien anekënd, kur ndajnë oriz stërkalash  
nëpër gurë:

— Do të luftoj te fronti m'i vështirë! —

Dhe i dëgjuan erërat.  
dhe ndonëse erërat s'dinë asnje gjuhë,  
këto tri fjalë i mësuam mirë,  
që t'i shpërndajnë vijave të sulmit:  
— Do të luftoj te fronti m'i vështirë! —

I shkrova këto fjalë mu në gji,  
ndërsa buçasin grykave përjetë.  
Ti. Zef Mark Gjoka, vdiqe shumë i ri...  
Kjo më takonte mua si m'i vjetër...

## **SI TË MOS KUVENDOJ ME TY?**

Ne kemi dhjetë vjet, që kuvendojmë bashkë,  
dhe sonte ndjej se kemi folur fare pak...  
Po del që nga shkëmbinjtë e bucura hënë:  
u thuaj, nesër, shoqeve qysh kuvenduam mbrëmë.

**Si të mos bisedoj sërish me ty  
për zogjtë, për planuçkat e për yjtë?**

Je lodhur, ndofta, përsëri në punë,  
qerpikejt të rëndojnë shumë,  
dh'ashtu, me gjumë ndër qepallë,  
të vjen sikur... po ngjitem nëpër shkallë.

**Po vij të kuvendoj sërish me ty,  
kangjellave të qerpikeve po hyj!**

Ti, ndofta, prap' lan plloçkat në kuzhinë,  
veç hapat e akrepit të prishin qetësinë...  
Mos m'u zemro në lënça disa gjurmë  
tashti, për pak, kur do të lëmë turnin.

Po vij të kuvendoj sërish me ty  
kangjellat e qepallave po shtyj.

Jam zhyer pak si shumë nëpër baltë.  
Mos më qorto nën këtë qiell të kaltër,  
se kurrë në jetë gjer në këtë orë  
s'jam ndodhur, jo, kaq pranë me punëtorët!

Ata më buzëqeshin, shpesh, me sy...  
Qysh mos ta sjell këtë sihariq  
tek ti!

## **KENGE PER ZOGUN E KUQ**

Dikur isha dhe unë fëmijë i prapë,  
vërvitja popla nëpër pellgje,  
qëlloja gushëkuqët nëpër shelgje,  
e s'lija fole brumbulli pa trazuar,  
e s'lija vezë breshke e turtulli...

Por një mëngjez (pak heret),  
tek kisha hipur kaliqafë mbi një shelg gërmuq,  
papritur del prej ferre  
një zog sqepverdhë,  
flakë i kuq.

Këndon

dhe zhdukет fët si erë!

I shkunda xhepat me haliçë,  
I lashë cinxujt e bretkosat  
guvave strukur;  
dhe nisa të kërkoj zogun e bukur.

I lashë në qetësi  
gargujt e mëllenjat,  
e hoqa dorë krejt nga gjuetia.  
Dhe, i trishtuar,  
mollëzat e gishtave me dhëmbë duke ndukur,  
kërkoja papushim zogun e bukur...

E shkuan muaj... vite...  
Gjurmoja nëpër ferra, nëpër driza, mrrete...  
kërkimet s'kishin fund...  
Por nuk e gjeja dot kurrikund.

Veç, kur të pashë ty  
gërshetëshpleksur,  
(kjo ngjau fare papritur)  
dhe sytë e tu që qeshnin tërë gaz:  
atë, që shumë vjet e kisha pritur,  
e harrova në ças!

Më ngjau sikur gjithshka ndryshoi në botë.  
Sikur e drejtoi shtatin  
dhe shelgu i zi gërmuq!  
E ti më shëmbëlleve me një pemë,  
ku cicëronin e këndonin

me qindra zogj të kuq.  
Po ky gëzim vazhdoi veç sa një ëndërr...

Një ditë ty të hipën mbi një kalë  
edhe të syrgjynosën,  
një vargan krushq.  
Më ngjau se ra mbi mua vjeshta,  
si gjethe të kuqërremta  
u këputën zogjtë e kuq,  
pastaj dhe vetë pema.

E nisa prap' të sillem nëpër botë  
si një shtegëtar,  
që s'di se ku e çojnë rrugët.  
E m'u bë jeta si një dimër i ftohtë,  
i zbrazët dhe i mugët.  
Dhe duke çarë bardhësinë si qefin,  
më ngjau sikur i gjeta zogjtë e kuq shpërndarë  
në dëborë.  
Medet — thërrita — mardhkan krejt të gjorët!  
Porse një zë i njohur  
më grishi nga thëllimi:  
— «Ecë në këto gjurma...»  
dhe pashë se nuk ishin zogj,

por bulëza gjaku.  
— «Ecë në këto gjurma... tërë jetën»  
tha partizani i plagosur  
dhe mbaroi.  
Dhe unë nga ky çast  
zbulova të vërtetën

## **POEZITË E MIA**

Koha, thonë, ecën si lumë.

Dhe ne të gjithë ngasim si rremtarë  
drejt skelave të reja  
dhe drejt fundit.

Të tjerë vinë marrin turnin.

Kjo është dialektikë.

Por unë s'dua që të kenë këtë fat dhe poezitë e mia,  
që pikojnë si hoje  
nga dashuria për të drejtën.

Koha ecën si lumë.

Dhe ne të gjithë ngasim si rremtarë  
drejt skelave të reja  
dhe drejt harresës.

Kjo është dialektikë.

Por unë s'dua që të kenë këtë fat dhe poezitë e mia,

që pikojnë si hoje  
nga dashuria për njerëzit.

Koha ecën si lumë.  
Dhe ne të gjithë ngasim si rrëmtarë  
                                  drejt skelave të reja  
                                  dhe drejt fundit.  
Kjo është dialektikë.  
Por unë s'dua që të mbyten poezitë e mia  
                                  në këtë det të kobshëm,  
pa e ngulur flamurin e kuq  
                                  përmbi çatinë e globit.

Koha ecën me nxitim.  
Dhe lot me papët, mareshalët dhe mbretërit,  
                                  sí macja me mijtë.  
Koha,  
      shkatërron shkëmbijtë,  
                                  shemb digat e malet,  
gërryen hekurin e çelikun.  
      zhvendos lumejtë,  
                                  përpin ligejtë,  
fashit vullkanet.  
Por unë nuk dua

t'ua fashitë sytë vargjeve të mia  
pa e parë planetin mbështjellë  
me shallin e purpurt të mait.

Koha,

ecën me ngulm pa u ndalur  
me këmbët e të gjithë shumëkëmbshve,  
me fletët e të gjitha fluturave, erërave  
dhe shpendëve.

Vrapon papushim:

si uji, si era, si zjarri, si drita,  
si milingonat dhe si galaktikat.

Koha,

që nuk di të lodhet as të kthejë kokën pas,  
as të ndalet,  
që nuk di të lozë klinxe, as të nusërojë,  
as të plaket;  
që mban në duar djepin, pipën e të urtit,  
dhe kokallat e vrasësit,  
që mban në duar acarin, pranverën, gushtin  
dhe gërshëret e gjykatësit—  
nuk do t'ua presë dot krahët këngëve të mia,  
në qoftë se do të pikoinë si hoje  
nga dashuria për Komunizmin.

## **TI DO TË VISH**

Ti do të vish!

Këtë ma thotë kjo shushurimë, tek del nga deti i qetë,  
e diçka pëshpërit që thellë,  
këtë ma thotë shiu, që cicéron në ombrellë,  
këtë ma thonë gjethet, këto trumba zogjsh të artë,  
që ti i do aq shumë,  
ndërsa pulitin krahët në hapësirë,  
këtë ma thotë rëra,  
tek janë vizatuar me miliarda gjurmë  
dhe koha, që të gjitha i ka fshirë.

Ti do të vish!

Edhe sikur të të zenë pritë  
të gjithë thashethemexhinjtë  
me hutat, me martinat e pisqollat mbushur.

Ti do të vish!

Këtë ma thotë dallëndyshja,

që pulitet e çukit pas strehës sqepin,  
këtë ma thotë pulëbardha,  
                kur shtrin krahët të pushtojë detin,  
këtë ma thonë tërë barërat e bimët,  
                që blerojnë në natyrë,  
këtë ma thotë syri i kaltër i burimit,  
                ku shikohen si në pasqyrë  
                xixëllonjat, hëna, yjet, diejtë.

Ti do të vish!

Edhe sikur me mijëra zëra të të thonë: — Ndal!  
                Edhe të hedhin zjarr mbi ty,  
                té gjitha flakëhedhëset e baterisë  
                té prapanikëve dhe mikroborgjezëve.

Ti do të vish!

Këtë ma thonë retë e bardha,  
kur vozitin si gamile  
nëpër qiellin e paanë.  
Këtë ma thotë zhurma e trenit,  
që trokon dhe rrëshqet mbi shinë,  
këtë ma thonë gjithë erërat,  
kur flladitin, kur gjëmojnë, e kur dremijnë.

Ti do të vish!

Edhe sikur të ngrihet para teje një pyll i tërë  
                me ikse dhe pikëpyetje,

edhe sikur të bjerë shiu rrebesh,  
edhe të mbushen rrugët plot me ujë  
edhe sikur...

Ti do të vish!  
Dhe unë do të ndjej sërish  
frymëmarrjen e detit pa kufi,  
që e dua dhe e adhuroj kaq shumë,  
dhe frymëmarrjen e kraharorit tënd...  
kur më vështron në sy,  
ose kur ëndërron gjysmëzgjuar, gjysmë në gjumë.

## **MOTIV KURBETI**

E martuan rastësisht...  
dhe ngeli e ve pas pak vitesh.  
Dhe askush më mirë se ajo nuk e di  
sa të gjata janë orët dhe vitet e pritjes.

Dhe ngeli ajo e ve:  
    me burrin gjallë,  
    mes gardhishteve të akullta të këshillave,  
    prapa perdeve,  
    prapa grillave;  
    mes mjerimit...  
dhe askush më mirë se ajo nuk e di  
sa të zeza janë netët e vetmisë  
mbështjellë me shallin e vejushës.

Dhe ngeli ajo e ve  
veshur me futën e zezë

dhe askush më mirë se ajo nuk e di  
se sa të rënda janë çastet në shtëpi,  
kur vjen çukit me sqep një dallëndyshe nën strehë  
e pret dikë të vijë  
dhe nuk vjen.

Dhe ngeli ajo e ve:  
mes hekurave të ndryshkura të zakoneve,  
mes grerëzave moralizuese të fjalëve,  
ikonë mes ikonave,  
mes të vdekurve e të gjallëve.

Dhe askush më mirë se ajo nuk e di  
sa zor të ligjërosh  
pas grilave të kafazit.

Dhe ngeli ajo me dekada duke pritur  
atë që nuk do të vinte kurrë.  
Pastaj harroi se ishte grua  
dhe mbrehu si burrë qetë në arë.  
Pastaj harroi se ish' e vetme  
edhe përcolli djemtë në luftë.  
Pastaj harroi se ish vejushë  
e qepi dhe vetë yllin në ballë.

## R A O R A :

*Shokëve tē mi tē vegjël tē Vaut tē Dejës,  
që punonin e mësonin.*

Shokët e mi e bijt' e mi tē dashur.

Jeni kërrusur në tryezë

edhe rrëmihni nëpër libra

me raportorë, kompase e riga

e një puhizë dheu ju shket pa u vënë re

nga duart e nga flokët

në fletore.

C'kérkonju kështu me kaq ngulm?

Ka kohë që po flenë shokët.

Ju vetëm zgjuar në fjetore.

Shokët e mi dhe bijt' e mi tē dashur!

Nuk është mbrëmja që merr frymë e shqetësuar,  
por unë.

Jam ulur katër hapa larg dritares  
në terr,  
si një kaçube:  
Akoma s'keni fjetur?

Pse kaq vonë kërrusur në tryezë?  
Ç'rrëmihni ju në bardhësinë pa fund të librave?

Shokët e mi e bijt' e mi të dashur!  
E di, nga dora juaj presin letra  
vëllezërit, shokët, nënët, motrat;  
e di se nesër ju pret shkolla...  
Po iku koha, e s'ju shoh në gjumë.  
Dhe kur të dalë tej, në grykë, hëna,  
më duhet t'u bëj zë të marrin turnin...  
Shokët e mi e bijt' e mi të dashur,  
ç'kërkoni ju me kaq ngulm përmbi fletore?  
Veç ju nuk keni fjetur në fjetore...

Veç ju...  
Po, dale, ç'më shikojnë sytë?  
Papritur keni varur kokën  
në tryezë,  
edhe po flini!  
  
Sa mirë që po flini!

E ç'ëndrra të bukura po shikonj vallë,  
në këtë gjumë të nxituar?  
E ç'fluturime adoleshente,  
ndër nebulozat e trëndafilita t'agimeve,  
në këtë gjumë të shqetsuar?  
E ç'takime flurore të këndshme e të pakapshme,  
në këtë gjumë të nxituar?  
E ç'dallëndyshe e zogj të shumëngjyrshëm kristalinë,  
në këtë gjumë të nxituar?  
E ç'zbulime të jashtzakonshme e të çuditshme,  
në këtë gjumë të nxituar?  
Hapësirat, shkencat, kohërat,  
për ju i hapën gjithë portat,  
në këtë gjumë të nxituar.  
E ja tek hyjnë,  
njëri pas tjetrit,  
Arkimedi,  
që ju dhuron të famshmen levë,  
(pasi e paska mbajtur shekuj me radhë fshehur),  
që të përmbyjni malet e të ndërtoni diga...  
Dhe unë duhet që t'ju zgjoj.

Mendelejevi,  
shpleks fije-fije mjekrën në tryezë.  
Shpleks gjithë fijet e ngatërruara të formulave.  
Dhe unë duhet që t'ju zgjoj.

E ja tek vjen ngadalë,  
ndofta që të mos ju prishë gjumin,  
i madhi Faradej,  
ju puth me dashuri në ballë,  
ju lëmon lehtas flokët,  
edhe lëshon për ju një grusht xixëllonja.  
Fletorja mbushet plot xixëllonja.  
Kantieri mbushet plot xixëllonja.  
Shqipëria mbushet plot xixëllonja.  
Dhe unë duhet që t'ju zgjoj,  
nga gjithë kjo ëndërr' e mrekullueshme!

Shokët e mi, e bijt' e mi të dashur!  
Ju flini...  
Dhe unë që-e di sa shumë jeni lodhur,  
dhe ju kam parë shpesh  
si grini me tehun e kazmës malin  
edhe si flini  
në pushim,  
me faqe mbështetur në një pllakë guri,  
duhet t'ju zgjoj.

Ju flini  
mbi fletore e mbi libra,  
në tryezë plot kalema, raportore e kompase,  
duke u kalamendur

në krahët e purpurta t'ëndrrave  
adoloshente,  
duke pérçarë qiejtë,  
duke përmbysur male, e duke ngritur diga  
dhe unë që e di se sa i shtrenjtë është pér ju  
vëngroshi gjumë,  
pas asaj lodhjeje të rëndë,  
e që ju dua kaq shumë...  
Duhet t'ju zgjoj.

Ju flini përmbi libra,  
në tryezën plot kalema, riga e kompase  
dhe unë që ju njoh kaq afër,  
mendoj se ka dhe sot  
nëpër kantiere,  
Gavroshë, Met Hasa, e Nik Pjetra.

Shokët e mi, e bijt' e mi të dashur!  
Zgjohuni. Ra ora!

\* \* \*

Kur tē takoj,  
megjithëse flas me ty pēr gjëra krejt tē ndryshme,  
vuaj, se s'mund tē them atë që ndjej.  
Konceptet, nganjëherë, janë më tē pathyeshme  
se vija Marxhino e Monrehejn.

Kur tē takoj,  
vërej se begonja ka diçka prej teje,  
(ndaj kam filluar që t'i dua dhe më shumë ato lule),  
vërej se, rrezet që vizatojnë arabeska  
në fytyrën tēnde,  
kanë diçka prej teje,  
(ndaj ka filluar tē më duket dielli më i afërt,  
e më i bukur)  
dhe vuaj se tē flas pēr gjëra më tē ftohta se akulli,  
e nuk tē shpreh atë që ndjej.

Kur të takoj,  
më vjen sikur të gjithë zogjtë e pyllit  
diçka për ty më cicërojnë në zemër;  
më vjen sikur të gjitha krojet e burimet  
po çuçuritin në kraharorin tim, për ty,  
                                të gjitha këngët,  
dhe unë,  
    që jam mbushur plot  
        me melodira e tinguj për ty,  
të flas me fjalë të shkurdisura e të shurdhëta,  
                                pa tinguj.

Kur të takoj,  
të gjitha zërat e natyrës  
                                tek unë bëjnë gojë  
dhe s'të flas dot një fjalë;  
të gjitha flladet e maleve dhe deteve  
                                bëhen fllad tek unë,  
e nuk të shpupuris dot një kaçurrele;  
të gjitha yjet e qiellit,  
                                bëhen sy tek unë  
dhe s'ngopem dot, duke të parë.

Kur të takoj  
megjithëse flas me ty për gjëra krejt të ndryshme,  
vuaj, se s'mund të them atë që ndjej.

## **NJERIU ME FENER**

Ku vete, Frrok, me atë fener në dorë?  
Ti po nxiton. Mos t'u bë vonë?  
Ku vete Frrok. Në gji të dheut po hyn,  
apo në galeritë e zemrave tona?

Të thella janë galeritë e tokës,  
por më të thella galeritë e zemrave.  
Ti ecën papushim në to,  
ku të njohën dhe ku nuk të njohën,  
edhe kudo që vete, shpie kohën.

Të gjata këto vraga e rrugë të nëndheshme  
në minierë,  
dhe ti e di fort mirë;  
se jashtë duhen nxjerrë  
tonelata baltë,  
që të dalë minerali i pastër.

Dhe ecën me guxim,  
pa e përpjekur kokën në xhungat e skalaktikëve  
dhe në bungat e dokeve të mykura,  
e pa u prapsur  
nga dhëmbët e kobrave e buzëqeshjet e skeptikëve.  
E çan ti me guxim, ku të njohën e ku nuk të njohën,  
dhe kudo që vete shpie kohën.

Të gjata janë këto vraga e rrugë të nëndheshme,  
por më të gjata korridoret e zemrave.  
Nxiton ti Frrok në galeri me kuti dinamiti,  
                                jo vetëm të minosh shkëmbinjtë,  
por edhe ndonjë kishë,  
                                që e ruan si altar ndokush në zemër,  
edhe ndonjë kullë.  
                                ku rri tulatur ende mesjeta,  
edhe ndonjë vilë,  
                                ku cicëron si kanarinë mikroborgjezia,  
                                kur punëtoria lan,  
                                me lumenj djerse,  
                                blozën e shekujve.

Dhe mbete tërë jetën thellësive,  
duke shkelur mbi gërmadha e mbi fosile,  
duke u plasur sytë kukuvajkave hijeve.

Dhe në shpërthefshin gazrat metan, si tufan i turbullt,  
ti nuk vdes.

Dhe në të rënçin shkëmbinjtë nga çatia e guvës,  
ti nuk vdes.

Dhe në të qëlllofshin qindra prita prapa krahëve,  
rrugës  
ti nuk vdes.

Dhe në të marrshin në shenjë nga deti  
treqind topa, e treqind anije  
lufte,  
ti nuk vdes.

Ecën në përjetësi,

me atë fener të kuq në dorë  
dhe ne ndjejmë papushuar hapin tënd të sigurt  
në galeritë e zemrave,  
si një zë të afërt dhe të dashur,  
që tingëllon gjithnjë thellië.

## **TE SHKRETET JU!**

### **KRITIZERËVE**

Të varfërit ju!

Qënje më të mjera se ju nuk kemi parë.

Bërtisni pa pushim

për «kohën», «modernen», «novatoren»

dhe harroni

se ini moshatarë me Noën.

Të zestë ju!

Kujtoni se na trembni

duke qëlluar me ca saçma,

sikur të jemi turtuj e mëllenja

që mund t'i vrasë dhe një saçmë qorre!

Lotshumtit ju!

Kulluat e kulloni vaj për poezinë

duke larë banakë, qoshe e korridore

me lotë ligavecësh,

edhe tërhequr prapthi si gaforre.

Të shkretët ju!  
Pse s'ini bërë kllounë?  
S'dihet ç'divizë vishni sot  
ç'divizë vishni nesër.

Atë që e ngrini tani gjer në qiell,  
e vrisni plotësisht pasnesër.

Atë, që e mbuloni në mëngjez  
me rubinë e me ndere,  
e flakni mbrëmjes pa të keq,  
në koshin e plehërave.

Ditëshkurtërit ju!  
Pse s'jeni bërë kllounë?

## PËR DITË BËHET MË E QARTE

Për ditë bëhet më e qartë,  
se kapadainjtë e liberalët mistrecë,  
sot janë cjetët e zgjebosur,  
që duhen përvëluar si karkalecë  
në furrën e gëlqeres.

Për ditë bëhet më e qartë,  
se ne, që shëmbëm dje  
meshnikë e gardhe,  
duhet të shkulim që nga rrënjet  
hatëre dhe tarafe,  
për të ecur papushim rrugës së madhe.

Për ditë bëhet më e qartë,  
se kurkund s'ka progres pa luftë e pa ndeshje;  
dhe fshati, sot, veç «me parmëndë e shatë»,  
do të qe një trupë luftëtarësh  
me ushta dhe përkërëse.

### **ATY KU JE TI...**

Aty ku je ti,  
ka erë, dritë, hije,  
e çdo gjë të pakapshme.

Aty ku je ti,  
ka diçka nga të gjitha materiet  
(thërrime rëre e grimcëza kozmike),  
ka diçka nga të gjitha dritat,  
ka diçka nga të gjithë tingujt,  
ka diçka nga të gjitha erërat...

Dhe unë,  
kur jam pranë teje,  
shoh gjithë universin,  
e nuk shikoj asgjë.  
Më duket se kam pirë gjithë kantinat e verës,  
e jam plotësisht i dehur.

Nuk jam sentimental.  
Dhe s'dua të mbetem si Keopsi,  
një mumje e trishtuar në muze.

Më mirë një grusht plehë në fushë,  
një popël në vreshtë,  
një dorë dhé në luadh,  
një plis në kopësht,  
se sa një mumje  
me emër të madh.

## **UNE I PËRGJIGJEM THJESHT**

Si folëm mjaft të dy, platin në dhomë heshtja.  
Ajo nis tjerr me laps një shkarravinë,  
unë vëzhgoj tërë kureshtje  
gishtérinjtë e saj të shkathtë në tavolinë.

Pastaj më mbështet në kraharor pëllëmbën:  
— Sa vend këtu zë unë? — flet me zë përkëdhelës.  
Unë i përgjigjem thjesht kësaj pyetjeje të rëndë:  
— Sa një xixëllonjë, mbrëmjeve të verës.

— Sa pak! — e dorën prap' m'a mbështet në gji:  
— E ç'jam, këtu, vallë unë? —  
më thotë si n'ëndërrim dhe sytë përgjysm' i mbyll.  
Përgjigjem fare thjeshtë përsëri:  
— Një laureshë, që cicëron në pyll.

Po kjo që them më duket fare pak,  
e nis të plotësoj me vete:  
— Ti je ajo që prek dh'ajo që s'mund ta kap,  
që e takoj një çast... dhe s'e harroj me vjete.

## **NATE BETONIMI**

Kërcasin rrotat nëpër shina,  
sikur po shkelin xhamë;  
vagonat njëshkolonë venë e vinë,  
si një karvan i vijave të para.

Na djeg gishtrinjtë hekuri i ftohtë.  
Po betonimi është si një rregull,  
apo si teoremë në gjeometri.  
Të zbetë duken reflektorët,  
si zjarret nëpër mjergull,  
si zjarret nëpër shi.

Vërtitin betonierat, rrëth kazanit lugët,  
e cërkë e llaçit na vesit fytyrën.  
Ne, betonistët,  
jemi si kirurgët,  
që s'mund ta lënë dot në mes detyrën.

Ja, akujt varen heje-heje  
pas strehëve dhe dërrasave të vjetra.  
Ne derdhim thasë çimento ndër govata  
me ngulm...

Si në një pozicion beteje.  
Pa vënë re qysh na zbardhojnë mjekrat,  
e na rëndoijnë vetullat e trasha.

Pa vënë re, që buza na ka piasur,  
(dy turne rresht më këmbë)  
dhe po na erren sytë pa cigar.  
Veç ka dhe ky mundim diçka të dashur...

«Ku mbërritëm, ku? Në çfarë thellësie»?  
Për çdo minutë lajmet venë e vijnë,  
sikur sulmojnë drejt ndonjë lartësie...  
Kërcasin rrotat përmbi shinë;  
dëbora fryn e bie.

Transheja ka uri, si një ushtri e lodhur.  
Stërkala llaçi na varen zhele-zhele  
nga flokët e nga rrobat.  
Transheja ha, përtyp e s'ndjen të ngopur.

Veç ka dhe ky mundim diçka të bukur.  
Betoni rrjedh drejt plasave të nëndheshme,  
tek mund t'na futen si mafije ujërat.  
Ne ngremë sonte murin e betonit,  
duke menduar nipat...  
Le t'na shikojnë me këtë gëzof prej pluhuri  
vitrinave kronikale të së nesërmes!

## **ME MIRE . .**

Kur e shikoj shokun tek bëhet urë,  
që të kalojë lopa e majme  
e konformizmit,  
mendoj me vete:  
Më mirë ta kish ngrënë pleviti,  
kur u sëmur  
në Operacionin e dimrit.

Kur e shikoj shokun,  
që përpëlitet kot,  
anohet,  
drithërohet,  
tërhiqet,  
mallëkon tokë e qiell  
deri baba e nënë  
dhe për çdo gjë ckërmitet dhe ofshan,  
mendoj me vete:

Më mirë të kish rënë  
në sulm, si partizan.

Kur e shikoj shokun,  
që lagavitet,  
gjoja me takt,  
dhe frenon para dilemës:  
«Kujt t'ja prish, e kujt t'ja ndreq»,  
mendoj me vete:

Më mirë të kish mbetur në vend  
nga një infarkt,  
duke i rrahur zemra për revolucionin,  
se sa të rrojë kështu  
njëqind vjet.

## M E T A M O R F O Z È

Mjekra i nxinte, e i shponte drizë,  
balli mezi i shquhej nga rrudhët,  
buzët i qenë pjekur...

Dyzet e tetë orë plot, në avari!  
E mekaniku K.,

më tepër shëmbëllente:  
me një elektromotor të djegur  
me një copë shkëmb në zall,  
me një aks të lënë,  
se sa me një njeri.

I urët,  
kthehej në mensë.  
Çapitej, duke u tundur  
edhe çuditej si nuk po rrëzohej.  
Kur rastësisht (!)  
(kështu ndodh shpesh)

i doli në kthesë  
vajza që desh.

E nisën t'i vezullonin sytë,  
si thëngjijtë kur u merr era hinë;  
e ju lagën buzët e thara,  
filloi të qeshte,  
rrudhat sikur muarrën arratinë...  
dhe humbën pak nga pak në një bisedë.  
që s'kish as fillim.  
as mbarim.

Dhe ndonëse bisedonin  
për sondat,  
për urbanet,  
për filmat,  
për ato dyzet e tetë orë avari.  
(kështu ndodh kur takohen në rrugë  
të dashurit)  
të gjithë e dinin,  
se ata të dy  
flisnin vetëm për dashuri.

## **DY MANDARINAT**

Të prura tërë gaz dy mandarina,  
se e dija që e do Rivierën shumë,  
ndërsa me duar në ije rrige  
buzës së detit, që gufonte shkumë.

Po ti më prite çuditërisht ftohtë:  
— Nuk i dua!  
Më mbeti shtrirë si e drujtë dora;  
m'u duknë mandarinat  
më të rënda e më të vogla.

Pastaj të pyeta njerëzisht:  
— Pse nuk i deshe?  
Ti m'u përgjigje prap' kryeneçe:  
— Nuk i dua!

E ktheve kokën, për inat, në tjetër anë,  
dhe pashë diellin lëmsh,  
që zhdukej pas dallgëve të detit.

Dhe mandarinat nga duart më shkanë,  
posi dy diej të vegjël,  
por nuk u thyen.

## N J E R I

E. ç'janë mbledhur bashkë sot:  
nëpunës, bojaxhinj, hamej, shoferë?  
Pse kaq automjete te ky shesh?  
Cigaret ndiz e shuaj pandërprerë...  
Pse kaq larush, e kaq i zymtë ky kortezh?

Dikush ka vdekur. Duket... Kush të jetë,  
ky që ka mbjellë kaq dashuri  
   mes njerëzve?  
Artist, ushtar a burrë shteti?  
Jo, Thimi Peristeri,  
   qymyrxhi.

Ne, sigurisht, e sjellim prapë në hatër  
atë dyqan gërmadhë.  
tek nxinin vazhdimisht çatia, muret, trarët  
dhe vetëm zemra e Thimit ish e bardhë.

Kish mbetur si yrnek nga bota e vjetër  
ai dyqan ahur,  
ku çdo gjë qe si një bodrum i ftohtë,  
rëndonte atmosfera plot me pluhur  
dhe vetëm zemra e Thimit ish e lehtë dhe e  
ngrohtë.

Na mbushte Thimi me qymyr kanistrat, torbat,  
thasët,  
(me lopata e me duar),  
i papërtuar e i lehtë,  
e gjente aq kënaqësi duke punuar,  
dhe mes të drejtëve ish njeriu më i drejtë.

Nuk kish asgjë të jashtëzakonshme.  
Punonte me ndërgjegje, e kish vetëm një ëndërr:  
të kenë në shtëpi, të gjithë, zjarr  
dhe të mos ndjejë dimër, asnjeri, në zëmër.

## **KUR TI MË MBËSHTETE KOKËN PËRMBI SUP**

Kur ti më mbështete kokën përmbi sup,  
m'u duk se kërrusi majën një borigë,  
e s'di pse ndjeva dhe gjëzim  
dhe frikë.

Kur ti më mbështete kokën përmbi sup,  
e disa fjalë të pakapshme më çuçurite,  
më zbrite krejt në tokë... në qiell më ngrite.

Kur ti më mbështete kokën përmbi sup,  
e më lakove llërën rreth si kulpër,  
pashë, syçelur, ëndrrën më të bukur.

## **A R M I K U**

Armiku nuk del, sot, me pallë sheshit.  
Eshtë mjaft elastik, e mjaft i mbledhur.  
Dhe, shpesh, ai na çuçurit te veshi  
ndonjë këshillë;  
apo citat të zgjedhur.

Veç rrëzave, ku mbi rrugoz, ku nën rrugoz,  
ku duke ecur majë gishtave,  
thua më tha;  
ku me të qeshur, ku serioz...  
Me katër rrokje derdh një lumë helm:  
«G'më duhet mua».

Armiku nuk pushon as ditë as natë.  
Të gjitha qenjet flenë:  
njerëzit, kafshët, peshqit...

Ai s'ka gjumë.

Dhe rrit, atë, ançarin degëshpatë,  
ku gjethet, shi farmak, vajisin krua,  
në rrugë, në kantier, në klub, në punë,  
që ka tri fjalë rrënëjë:  
«Ç'më duhet mua».

Të ngjitet pas gjithkund,  
ai,  
siç ngjitet balta pas këpucëve:  
Të kreh, të ngre, të miraton,  
të mburr ndër sy...  
E shan ndokënd, si rastësish, me cep të buzëve;  
dhe prap' të çmon guximin, aftësinë e përvojën;  
«Të vlerëson»,  
nuk ke ç'i thua!  
Një gjë «të vogël», vetëm, do nga ti:  
të kyçesh gojën  
me «TITIUS»-in «Ç'më duhet mua».

Dhe, pikërisht, këtë  
«Ç'më duhet mua»,  
e injekton, ai, tërthorazi, rrëshqitazi,  
me gjeste, me vështrim, me buzëqeshje,  
me zë edhe pa zë;  
duke nxituar linkth,

duke kaluar brinjaz,  
duke rrëshqitur barkaz,  
duke nuhatur si langua...  
«Ç'më duhet mua».

Armiku kapet fort pas llafazanëve,  
dembelëve dhe impotentëve,  
posi kope e ujqve pas kërmave.  
Dhe ndjen ai gëzim e lumturi,  
kur shton (edhe me një) numrin e indiferentëve,  
n'atë regjistrin e vet të zi  
të të paqenëve;  
kur vëren se në librin e të vdekurve» dhe një i  
gjallë u shtua.  
«Ç'më duhet mua».

\* \* \*

E pyeta të dashurën një ditë:

— Më do?

Edhe në çast m'u duk sikur i thashë zogut:

— Je i vogël?

Sikur i thashë fluturës:

— Je e lehtë?

Sikur i thashë borës:

— Je e bardhë?

Sikur i thashë flakës:

— Je e nxehjtë?

Sikur i thashë lulëkuqes:

— Je e kuqe?

Sikur i thashë lules:

— Je e bukur?

E, që ta ndreqja sadopak

këtë gabim të lehtë,

i thashë më të qeshur prapë:

— Më do?

Ajo më lëmoi flokët:

— Jo!

## S T E N D A

Ka shkruar turni, sot, tek stenda e kuqe  
një fletërrufe,  
për atë që vret kohën.

Kalon ai nën stendë, e bën sikur s'e sheh...  
Ndonëse e ndjen se që të gjithë e shohin.

E shoqëron ajo gjithkund,  
me sytë e shokëve bashkë,  
dhe nuk i ndahet asnjë çap.  
I vjen sikur i thonë punëtorët:  
— Qysh s'të vjen pak turp!  
E ke gjymtuar teturëshin prap'?

Fillon e fryn kantierit era e marrë.  
Ai mendon:  
«Tufani, sigurisht, ka për t'më zhdukur...»

Përgjigjet fletërrufeja mes një reje pluhur:  
«Tetorëshin, dembel, ti e ke vrarë!»

Fillon e bie gjithë natën shi.  
Pi dheu sa mund, e lindin pellgje nëpër tokë.  
Ai mendon me shpresë:  
«Sot fletërrufe në stendë nuk do shohëm...»  
Ja bën ajo nga stenda, prapë me kokë:  
«Hej, ti ke pushkatuar kohën!».  
Ai hap sytë... lahet krejt në djersë.

Qëndron ajo, në shi dhe në erë,  
gjithnjë,  
dhe për çudi, një ditë, fillon e i bën zë:  
«Hej, ti, që vret tetorëshin! Duam përgjigjen...»  
«Ja, menjëherë! i flet ai i shtangur,  
e faqet zjarr i digjen.

Pastaj, si nëpër mjergull,  
i shfaqen, fët, përpara  
kallinj të fishkur,  
pallate pa çati,  
qytete gjysmë të rrënuar,

pemishte, vreshta të molepsura e të thara:  
«E ç'janë gjithë këto varreza?!» pyet ai me habi.  
«Tetorësha të gjyqtuar...  
Ditë-pune të vrara!»

**Zadejë 1968-1969**

\* \* \*

Të gjitha rrugët, që na shpinin drejt njëri-tjetrit  
  i shëmbëm,  
të gjitha urat që na lidhnin me njëri-tjetrin  
  i premë,  
letrat, ku kish pikuar malli i kaq viteve  
  i dogjëm,  
(oh, po të kishim përvëluar kockat tonë,  
  nuk do të na përvëlonin kaq sa këto letra!)  
të gjithë zogjtë që cicëronin në krahërorët tanë  
  për dashurinë,  
i përcuallëm për shtegëtim  
  nëpër vende të ngrohta:  
tashti s'ka mbetur asnje rrugë,  
  që të na shpjerë drejt njëri-tjetrit,  
tashti s'ka mbetur asnje pëllumb,  
  që t'na shpjerë e të na bjerë postën,  
tashti s'ka mbetur asnje urë,  
  që të na bashkojë,

e megjithkëtë (pikërisht në këto çaste)  
unë ndjej, se nuk kam qenë me ty asnijëherë  
më i afërt, se sa në këto çaste,  
dhe, pa harruar veten, ujin, ajrin, diellin  
unë nuk do të harroj dot ty, kurrë.

## KURRKUND NUK JEMI VETËM

*Sipas tregimit të zjarrmëtarit  
Avni Mestani.*

Ti kishe kohë të largoheshë, Telo.  
I pe tek po harbonin minjtë,  
«kasnecët» e katastrofave,  
dhe kishe kohë t'i shmangeshe përleshjes nën tokë  
edhe t'u shpije minatorëve mandatën:

— Na mbeti Salua, shokë!  
Ju ishit vetëm dy në atë oxhak.<sup>1)</sup>  
Një ra, e mbete ti.  
E shokët ndodheshin larg...

E pe ti Salon, para tek anohej  
dhe dritën e kandilit, që ndrinte si në mjegull.

---

1) Galeri bijë, pa krye, që përdoret për shfrytëzimin e shtresave të qomyrit.

E mund t'u jepje këmbëve,  
pa shkelur asnjë urdhër,  
pa shkelur asnjë rregull...

Karbiti zu të digjej më ngadalë.

E Salua ra,  
në atë «oxhak»,  
që e degëzonte galeria,  
pa thënë dot një fjalë.  
Kandili gjithnjë zbehej.

Dhe Telua e ndjente vdekjen mes rrembave të tija.

Dhe Telua e ndjente,  
se mushkëritë me ajër s'po i mbushte,  
dhe kish veç pak sekonda të largoheshe.

E mund të ngopej jashtë me oksigjen,  
(Oh, ç'mrekulli në këto çaste ajri i freskët!)  
dhe mund të nginjej jashtë,  
me ujë të kthjellët e me diell,  
dhe mund t'ja shplekste nuses prapë

leshërat.

Dhe mund t'u gëzohej bajameve, që posa kishin  
celur.

E mund të rronte buzë Vjosës,  
në atë qytet punëtor dhe gjysmë shekulli.

Dhé nuk u kthye Telua.  
U turr ai, aty, ku kishte mbetur  
minatori.  
Dhe, ndonëse i shikonin sytë nëpër mjegull,  
dhe, ndonëse i zhuritnin buzët, fytì e mushkëritë,  
dhe, ndonëse duhej të zvarritej me bërryl, e në  
gjunjë,  
ndërsa e ndjente qysh i shtereshin fuqitë,  
dhe errësohej galeria çdo sekondë më shumë,

sulmoi... të mbronte jetën  
me një mendim të madh në gji:  
«Ne, punëtorët... kurrkund nuk jemi vetëm»!

E rrroku Salon,  
edhe filloj tërheqjen.  
Dhe lufta në «oxhak» qe shumë e fortë.  
Mbinjerëzore kjo përpjekje.  
Dhe heroike qe kjo luftë...  
Dhe heroike qe kjo vdekje.

Kështu e mbrojti Telua shokun atje në galeri,  
dhe shkoi ai...  
por pa i thënë këto fjalë

s'mbetën:

— Ne, punëtorët, kurrkund nuk jemi vetëm.

*janar 1970*

## **NE DUHET TË ECIM SI KOMETE**

*Shoferit Zef Gjetani*

Kamioni gjarpëron. Dridhet në zenit akrepi i kilometrazhit.

Shkëlqen e buzëqesh pas shirave të pranverës  
në fusha e kodrina,

peisazh i mrekullueshëm.

Po Zefi zjen përbrenda:

«E marrtë dreqi barkalecin turkoshak «avash-avash»!  
E shkel prapë dhe një marsh.

Fryni veriu. Asfalti ndrin posa inxhi nga vesa.

Kamioni merr si një furtunë kthesat;  
dredhon edhe rrëshqet si vuvëz

nëpër dredhëza.

Zefi çon buzën në gaz:

«Nxito välla.. se në dhjetor pret Fierëza».

Kamioni ecën mirë. Zefin e presin.  
Ç'gjë e këndshme dhe e bukur kur të presin.  
Kur dy sy të përlotur nga gëzimi  
flasin me ty, e qeshin...

Kamioni çan si vetëtimë.  
Kalojnë në revistë lugina, fusha, brigje, male.  
E Zefi gjithë mllef valon përbrenda:  
«Në varr të qenit vafsh!»

Ö rakinika gjerdallë:  
«Punët e mira bëhen me ngadalë».  
E shkel, fët, dhe një marsh.

Dhe prapë mendon:

«Ne duhet t'ecim si kometë, më shpejt se shpejtësia  
vetë!»

É shtrin pareshtur krahët,  
posi shqiponja  
mbi hapësirat e mëdha,  
që të pushtojë shekujt...

## BALLË PËR BALLË AMERIKËS

Mes nesh ka mijra milje det e valë,  
por diku larg, një mbrëmje me muzikë,  
flamurët tanë ndodhen në një sallë;  
një çap larg teje jam o Amerikë!<sup>1)</sup>

Ti mund ta ngjyesh tokën krejt në ar  
dhe detet plot t'i mbushësh me anie,  
por unë, dije, prapë jam krenar  
se jam një qytetar prej Shqiprie.

Ne kemi ecur zbathur nëpër gurë,  
kemi shtrënguar rripin të uritur,

---

1) Në një qytet të huaj, një grup afaristësh janki me flamurin e SH. B. të Amerikës mbi tryezë, krenoheshin pranë meje.

por dorën për lëmosh' s'e ndemë kurrë  
dhe nderin për flori s'e kemi shitur.

Ne kemi qenë bujqër tërë jetën  
dhe tokën grismë me par mend' e branë,  
por se në fyt s'e mbytëm të vërtetë,  
s'u veshëm fajdexhinj e gardianë!

Zezakët ne s'i shitëm e si ropëm,  
lavdi me lek' ne kurrë s'kemi blerë.  
Një grusht, — po mbrojtëm burri shisht Evropën,  
kur ti, po, ti edhe nuk kishe lerë.

Në kozmos ne s'do t'nisim sot raketë,  
ndër malet tonë ndihet ende çanga.  
Por dhe në qìell, moj Amerik' e shkretë  
ti do t'dërgosh sherifë edhe pranga.

Ti po më sheh, si dreq, me sy të ngrirë,  
kaq pranë kurrë s'të kam pasur ty.  
O Amerik' e madhe, vjetërsisë!  
Unë të shoh, me mburrje, drejt në sy!

## **PËR INAT TË VDEKJES**

Është diçka njerëzore,  
                             të kujtosh atë që ke dashur,  
është diçka njerëzore,  
                             të qash atë që ke dashur;  
është diçka njerëzore,  
                             të shpiesh një tufë lule  
                             në varrin e atij që ke dashur;  
është diçka njerëzore,  
                             të gdhendësh emrin e tij  
                             përmbi një pllakë prej mermeri;  
por jo të vishesh me të zeza  
                             dhe të harrosh të qeshësh  
                             dhe të mos vesh re se dita çel e bardhë;  
                             dhe të mos dëgjosh zërat e gjëzuara të fëmijëve  
                             e cicërimat e zogjve  
dhe të mos vesh re sejeta është mbushur plot me  
tinguj, e ne po bëjmë luftë titanike  
për ta bërë sa më muzikale e sa më të gjerë,

dhe të varrosh brenda katër mureve për së gjalli  
në një vdekje të ngadalshme e të gjatë,  
si gratë e Perandorit Cin<sup>1</sup>),  
por jo të vishesh me të zeza...

**Shoqe,**  
merr sharrën e zemërimit  
dhe sharroji tërë bravat e grilat,  
tërë hekurat e prangat e padukshme  
që të mbajnë mbërthyer —  
për inat të vdekjes.

**Shoqe,**  
ngri grushtin  
e thyejua kokën  
atyre  
që të numërojnë kafshatat,  
duke çjerrë faqet  
e duke murmuritur psallme të shtunave,  
dhe eja me ne,  
që po ngremë një botë të mrekullueshme —  
për inat të vdekjes.

---

1) Kur vdiste perandori, në Dinastinë e Cinëve, varroshin të gjalla edhe gratë e tij.

Shoqe,  
çeli gjithë dritaret,  
(në dreq psherëtimat e pambaruara të vejushës)  
të hyjë në çdo kënd të shtëpisë

flladi fluturak i maleve, zhurma e qytetit dhe  
gjerësia e fushës-  
për inat të vdekjes!

Shoqe,  
hiqe futën e zezë  
dhe vish një fustan të bukur  
që të ketë tërë ngjyrat e luleve dhe të stinëve  
dhe qesh me gjithë shpirt,  
ashtu siç di të qeshësh vetëm ti —

për inat të vdekjes!

1. 100% of the time, the  
operator can see the  
operator's own hands.  
2. 100% of the time, the  
operator can see the  
operator's own hands.

3. 100% of the time, the  
operator can see the  
operator's own hands.  
4. 100% of the time, the  
operator can see the  
operator's own hands.  
5. 100% of the time, the  
operator can see the  
operator's own hands.

## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Përsëri në liqenin e Vaut të Dejës .....	3
Partia .....	4
Dikush mendon .....	7
Thëngjij të kuq .....	10
Vij në shtëpinë e prindërve .....	13
Sa herë do të shikojmë malin e Dajtit .....	17
Kur shkonim në luftë .....	20
Ka fjalë .....	21
Përpara .....	23
Jam moshatar .....	26
Dritaret .....	27
Zjarrmëtari .....	30
Natë në kantier .....	34
Ditën që u bëre ti dy vjeçë .....	35
Duke kuvenduar me Niko Bellojanisin .....	37
Vështroj këtë liqen dhe nuk di... .....	41
Ka mbi një çerek shekulli .....	43
Mesnatë .....	44
Raqka .....	45
Ca pika shiu .....	47
Kur shkova përsëri në fshat .....	48
Çudi .....	50
Pushtimi i lartësisë .....	51
Nën një vështrim të akullt .....	54
Nëna .....	55
Ka bota plot qytete .....	57

	Faqe
Revolucioni .....	60
Musonet .....	61
Poet .....	65
Ernesti .....	67
Lamtumirë mësuese .....	69
Ja poezia .....	71
Elegji për kryesondistin .....	74
Si të mos kuvendoj me ty? .....	77
Këngë për zogun e kuq .....	79
Poezitë e mia .....	83
Ti do të vish .....	86
Motiv kurbeti .....	89
Ra ora .....	91
Kur të takoj .....	93
Njeriu me fener .....	98
Të shkretët ju .....	101
Për ditë bëhet më e qartë .....	103
Aty ku je ti. ....	104
Nuk jam sentimental .....	105
Unë i përgjigjem thjeshtë .....	106
Natë betonimi .....	108
Më mirë .....	111
Metamorfozë .....	113
Dy mandarinat .....	115
Njeri .....	117
Kur ti më mbështete kokën përmbi sup .....	119
Armiku .....	120
E pyeta .....	123
Stenda .....	124
Të gjitha rrugët .....	127
Kurrkund nuk jemi vetëm .....	129
Ne duhet t'ecim si kometë .....	133
Ballë për ballë Amerikës .....	135
Për inat të ydekjes .....	137

**Redaktor: PANDELI KOÇI**

**Piktor: SVJETLLANA STRAZIMIRI**

---

**Tirazhi 4.000 kopje      Format 70x100/32      Stash: 2204-72**

---

**Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike  
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1973**